



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-115

Prishtinë, më 24 qershor 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 24 QERSHOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq, Myfera Shinik dhe Goran Marinkoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë.

Ai propozoi që pika 2.5 të hiqet nga rendi i ditës dhe këtë e miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 17 qershor 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 17 qershor 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 17 qershor 2013.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 27 qershor 2013, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit të kësaj marrëveshjeje,
5. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës,
6. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2012,
7. Njoftim për propozimin e Grupit Parlamentar SLS dhe të Grupit Parlamentar 'ZB' për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2014, në bazë të Qarkores së parë të Ministrisë së Financave 2014/01

Sekretari i Kuvendit, z. Ismet Krasniqi, i njoftoi në hollësi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2014, në bazë të Qarkores së parë të Ministrisë së Financave 2014/01.

Kryesia, pasi e shqyrtoi rekomandimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesat buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bazë të Qarkores së parë të Ministrisë së Financave 2014/01, sipas pasqyrave të paraqitura.
2. Kërkesat buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2014 i dërgohen Ministrisë së Financave, që të përfshihen në Projektbuxhetin për vitin 2014.

Kryetari kërkoi nga Administrata e Kuvendit që ta përgatisë dokumentacionin e nevojshëm për mëvetësimin e buxhetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga Ekzekutivi i vendit.

2. Propozimi i GP ‘ZB’ për përfaqësim në organet e Kuvendit

Kryesia vendosi që propozimi i GP të SLS-së dhe GP ‘ZB’ për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të radhitet në rend të ditës në mbledhjen plenare, më 27 qershor 2013.

3. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Belgjikë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i deputeteve të Kuvendit Blerta Deliu-Kodra dhe Aurora Bakalli për vizitë zyrtare me qëllim të informimit të drejtpërdrejtë mbi politikat e NATO-s dhe zhvillimet e marrëdhënieve të Aleancës me partnerët e saj, e cila do të zhvillohet në Belgjikë, prej datës 30 qershor deri më 4 korrik 2013.
2. Shpenzimet e akomodimit dhe të ushqimit për të lartshënuarat në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga organizatori - Asambleja Parlamentare e NATO-s, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjeve shtesë mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

4. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Austri

Kryesia diskutoi për kërkesën lartshënuar, si dhe për kërkesat e tjera për udhëtime jashtë vendit dhe konstatoi që kërkesa të shtyhet për mbledhjen e radhës, me arsyetimin se duhet konsultuar organizatorin e takimit për rimbursimin e shpenzimeve për këtë udhëtim.

5. Njoftimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me vizitën zyrtare, të realizuar në Londër, prej datës 2-5 qershor 2013

Kryesia u njoftua me vizitën e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, të realizuar në Londër, prej datës 2-5 qershor 2013.

Pikat shtesë:

1. Kërkesa për GP të AAK-së për mbajtjen e seancës solemne me rastin e përvjetorit të Deklaratës Kushtetuese më 2 korrik 1990

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, konstatoi se kërkesat për të ftuar seancë solemne duhen të parashtrohen në përputhje me përfundimin e Kryesisë së Kuvendit, nr.04-P162/k, datë 20 maj 2013, që nënkupton se ajo duhet ta ketë konsensusin e të gjithë anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit dhe kryetarëve të grupeve parlamentare.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale